



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
REKTORI

Nr. 1157 / prot.

Elbasan, më 11.05.2026

URDHËR

Nr. 60 /, datë 11.05.2026

**"PËR SHTYRJEN E PROCESIT TË KANDIDIMIT PËR ANËTAR TË
KOMISIONIT INSTITUCIONAL ZGJEDHOR STUDENTOR DHE ANËTAR TË
KOMISIONIT TË APELIMIT STUDENTOR TË UNIVERSITETIT TË
ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 68 të Statutit të Universitetit "Aleksandër Xhuvani" Elbasan, Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për Këshillin Studentor të Universitetit "Aleksandër Xhuvani", si dhe në zbatim të Urdhrit të Rektorit nr. 60, datë 05.05.2026, në kushtet e mungesës së kandidatave të paraqitura brenda afatit të përcaktuar nga studentët e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe Fakultetit të Shkencave Humane, me qëllim garantimin e zhvillimit të procesit zgjedhor dhe krijimin e mundësisë për paraqitjen e kandidatave nga studentët.

URDHËROJ:

1. Shtyrjen e procesit të kandidimit për anëtar të Komisionit Institucional Zgjedhor Studentor për studentët e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe Fakultetit të Shkencave Humane
2. Shtyrjen e procesit të kandidimit për anëtar të Komisionit të Apelimit Studentor për studentët e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, Fakultetit të Shkencave të Edukimit dhe Fakultetit të Shkencave Humane.
3. Regjistrimi I kandidatëve të shtyhet deri më datë 13.05.2026.
4. Kandidatët e interesuar të dorëzojnë kërkesën për vetëkandidim pranë zyrës së Protokoll Arkivës së UE-së.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

REKTORI

Prof. dr. Elvira Fetahu

